

1 E hënë, 7 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë Përgatitore për gjykim]

4 [Të akuzuarit Januzi dhe Bahtijari hyjnë në
5 sallën e gjyqit përmes videolidhjes]

6 [I akuzuari Shala hyn në sallën e gjyqit]

7 --- Seanca fillon në orën 09.30

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Mirëmëngjesi, të gjithëve dhe mirë se erdhët në sallën e
10 gjyqit.

11 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
13 çështje KSC-BC-2023-10, Prokurori i Specializuar kundër Sabit
14 Januzit, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shalës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
16 lutem palëve dhe pjesëmarrësve të prezantohen, duke filluar
17 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

18 Z. Prokuror, fjala është për ju.

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
20 jam Joshua Hafetz, jam nga Prokuroria e Specializuar. Këtu kam
21 dhe kolegët e mi, Prokurori Kimberly West, Ndidhmësprokurori
22 John Devaney dhe Administratoret e lëndës Line Pedersen dhe
23 Aniko Boldog.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
25 lutem Zyrës Administrative të prezantohet.

1 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë.

2 Unë jam Zëvendësadministratori Jonas Nilsson. Kam dhe një
3 jurist këtu dhe jemi përfaqësues të Zyrës Administrative.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
5 drejtohem Mbrojtjes tani. Ju lutem të më thoni gjatë
6 prezantimit kush po na ndjek përmes videolidhjes dhe kush
7 është i pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit. Të njëjtën gjë
8 thoni dhe për klientët tuaj, se sot kemi një lloj organizimi
9 hibrid.

10 Fillojmë me Mbrojtjen e z. Shala.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
12 Jam Toby Cadman, Mbrojtësi i specializuar i z. Haxhi Shala që
13 është i pranishëm në sallën e gjyqit sot me ne. Në fakt, ekipi
14 është i pranishëm në sallën e gjyqit. Ne nuk kemi asnjë nga
15 ekipi që po na ndjek përmes videolidhjes. Unë kam në të majtën
16 time z. John Cubbon, kam po ashtu z. Admir Berisha, kam edhe
17 Isabella Kirwan që është juriste, po në sallën e gjyqit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
19 lutem Mbrojtjes për z. Bahtijari. Kush do ta marri fjalën?
20 Kryembrojtësja?

21 ZNJ. GERRY [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. Jam
22 Felicity Gerry, jam Mbrojtësja e z. Bahtijari, kam znj.
23 Carrin, që është e pranishme në sallën e gjyqit, po këtu
24 Phillipa Stafford e Caitlin Delaney, janë asistente
25 administrative, thjesht janë për qëllime vëzhguese sot për të

1 parë çfarë po ndodh.

2 Duhet të kisha thënë duke thënë mirëmëngjes në fakt
3 Kryegjykatëses, e mirëmëngjesi të gjithëve në sallën e gjyqit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit.

6 Mbrojtja e Januzi, fjala është për ju.

7 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë jam
8 Jonathan Rees. Po ju ndjek përmes videolidhjes. Kam
9 bashkëmbrojtësin tim Huw Bowden, që po ashtu po na ndjek
10 përmes videolidhjes edhe po ashtu z. Januzi, që po na ndjek
11 nga njësia e paraburgimit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Z. Shala, jo, mund të qëndroni ulur. Qëndroni ulur. Z.
15 Shala, Z. Bahtijari, që po na ndjek nga njësia e paraburgimit
16 dhe z. Januzi, dua t'ju rikujtoj që të gjitha të drejtat që
17 gëzoni sipas ligjit dhe rregullores sikurse ua ka lexuar
18 Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjatë paraqitjes fillestare,
19 vlejné ende edhe para këtij Trupi Gjykues, përfshirë këtu të
20 drejtën tuaj për të mos folur, për të qëndruar të heshtur.

21 Faleminderit. Kolegët e mi janë Gjykatësi Roland Dekkers,
22 Gjykatësi Gilbert Bitti dhe Gjykatësi Vladimir Mikula, që
23 është Gjykatës Rezervë. Dhe unë jam Mappie Veldt-Foglia, jam
24 Kryegjykatësja e kësaj lënde gjyqësore.

25 Do bëj një prezantim të shkurtër përpara se të fillojmë

1 me seancën.

2 Më 4 shtator 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i
3 kaloi çështjen Trupit Gjykses numër 1, që ishte emëruar nga
4 Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës për këtë lëndë
5 gjyqësore.

6 Më 24 shtator 2024, Trupi Gjykses nxori një vendim ku
7 planifikohet konferenca për përgatitjen e këtij gjykimi për
8 datat 7, 8, 9 dhe nëse është e nevojshme edhe 10, 11 tetor
9 2024. Në të njëjtin vendim, Trupi Gjykses u kërkoi palëve dhe
10 Zyrës Administrative të bënin parashtrimet përkatëse lidhur me
11 disa aspekte sa i takon mbledhjes së informacionit përkatës
12 për të ndërmarrë hapat e radhës për fillimin e gjykimit.

13 Parashtrimet tuaja i morëm në 1 dhe më 2 tetor.

14 Qëllimi i seancave që kemi në këtë javë është të
15 përgatisim sa më shpejt këtë çështje për gjykim sipas
16 Rregullores së Procedurës dhe Provave, për ta bërë këtë bashkë
17 me ZPS-në, me Mbrojtjen dhe me Zyrën Administrative.

18 Synimi është të marrim parashtrime të mëtutjeshme krahas
19 parashtrimeve që keni bërë me shkrim, që tashmë i kemi marrë,
20 lidhur me çdo aspekt që duhet zgjidhur në mënyrë që të
21 fillojmë me këtë gjykim, idealisht, në nëntor 2024. Duke marrë
22 realisht kuadrin e kufizuar të kësaj lënde gjyqësore, të
23 dhënat e kufizuara dhe ecurinë që ka bërë kjo çështje që nga
24 faza paragjyqësore deri në kalimin e çështjes te Trupi
25 Gjykses, duke marrë parasysh se tri të akuzuarit janë në

1 paraburgim që prej tetorit dhe dhjetorit të vitit të kaluar,
2 Trupi Gjykses pret që palët të jenë gati të fillojmë gjykimin
3 sa më shpejtë.

4 Ky Trupi Gjykses ka për detyrim të administrojë në mënyrë
5 efikase procesin gjyqësor për të garantuar një gjykim të
6 shpejtë dhe të drejtë.

7 Trupi Gjykses do të ndër marrë të gjitha hapat e nevojshme
8 për ta realizuar këtë dhe pres bashkëpunim të plotë prej të
9 gjitha palëve dhe Zyrës Administrative.

10 Sa i takon synimit të seancave të kësaj jave, besoj se e
11 keni të gjithë të qartë se sot nuk do diskutojmë fajësinë a
12 pafajësinë e të akuzuarve dhe se nuk do të fillojmë shqyrtimin
13 e provave.

14 Në rregull. Tani sa i takon kalendarit për ditët në
15 vijim.

16 Kalendarit është i parashtruar në fakt në vendimin për
17 organizimin e Konferencës për Përgatitjen dhe për Gjykim,
18 parashtrimi F00479, paragrafi 11. Sot do të kemi katër seanca
19 nga 1.30 secila. Do bëjmë një orë pushim 1.00 deri në 2.00.
20 Dhe, nëse është nevoja, do të kemi të njëjtin organizim të
21 martën dhe të mërkurën. Se duke përdorur katër seanca në një
22 ditë maksimizojmë mundësinë që të kemi sa më shumë Mbrojtje të
23 Specializuar në këtë seancën për përgatitjen për gjykim.

24 Në rregull. Tani rendi i ditës do jetë ky: Fillimisht do
25 të ftoj palët dhe Zyrën Administrative të bëjnë parashtrime të

1 mëtutjeshme lidhur me pikat në rendin e ditës. Do t'i trajtoj
2 secilën veç e veç. Ju lutem mos përsërisni parashtrimet që
3 tashmë i keni bërë me shkrim dhe ju lutem do t'i bëni
4 parashtrimet sipas kërkesave që do bëjë unë sipas rendit të
5 paracaktuar.

6 Së dyti, do trajtoj disa çështje shtesë që kanë dalë
7 javën e kaluar.

8 Së treti, palëve do t'u jepet mundësia dhe Zyrës
9 Administrative, sigurisht, të ngrenë pika të tjera që nuk janë
10 në rendin e ditës dhe në urdhrin për këtë konferencë dhe ju
11 lutem pikat shtesë që keni, do t'i bëni në momentin që do t'ju
12 them unë, do të kenë momentin e caktuar.

13 Dhe në fund, do të nxirren disa urdhra me gojë dhe do
14 t'ju informojmë lidhur me vendimet që synon të marrë ky Trupi
15 Gjykses për periudhën e ardhshme. Këto urdhra me gojë
16 sigurisht nuk do t'i japim sot.

17 Në rregull. Kujtoj palët, Zyrën Administrative, të më
18 njoftojnë paraprakisht nëse ndonjë prej parashtrimeve përmban
19 informacione konfidenciale, në mënyrë që të kalojmë në seancë
20 private ose të mbyllur.

21 Ka persona që po na ndjekin nga salla e gjyqit dhe të
22 tjerë përmes videolidhjes, prandaj ju lutem merreni fjalën kur
23 t'ua jap unë qartë fjalën. Kur flisni njëkohësisht është shumë
24 e vështirë sepse nuk zbardhet procesverbali i kësaj seance dhe
25 nuk është i qartë dhe nuk do jemi dot në gjendje të kuptojmë

1 njeri-tjetrin, se dhe qëllimi kryesor, një nga qëllimet e
2 kësaj seance është që ne të kuptohemi, të merremi vesh.

3 Nëse personat që na ndjekin përmes videolidhjes duan
4 fjalën dhe, sigurisht që do ta keni shpesh fjalën sot për
5 parashtrimet tuaja, po nëse në një moment të caktuar doni të
6 flisni, ju lutem shtypni ikonën e shenjës dora dhe do ta
7 kuptoj, do t'ju jap fjalën.

8 Do të fillojmë tani me pjesën e parë të rendit të ditës
9 që është hetimi dhe nxjerrja e provave.

10 Ne udhëzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar të na
11 konfirmonte nëse ka përfunduar hetimi dhe nxjerrja e provave
12 inkriminuese për këtë lëndë gjyqësore.

13 Z. Prokuror, ne kemi marrë parashtrimet tuaja sa i takon
14 nxjerrjes së provave inkriminuese. Unë do të bëj një
15 përmbledhje të shkurtër, nuk do t'i lexoj të gjitha
16 parashtrimet, kuptohet, por sidoqoftë një përmbledhje është e
17 rëndësishme.

18 Z. Prokuror, vërejmë që ZPS-ja do t'i dorëzojë një
19 kërkesë Trupit Gjyqësor për shtuar një sërë provash në listën e
20 provave materiale. Ka disa materiale që ende nuk janë në
21 zotërim të ZPS-së që do të nxirren dhe përkatësisht do t'i
22 shtohen listës së provave materiale që është miratuar
23 paraprakisht tashmë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Dhe
24 është bërë një rishikim i materialeve të nxjerra çka ka sjellë
25 disa nxjerrje materiale të mëtutjeshme muajin e kaluar.

1 Po shoh që po pohoni me kokë.

2 ZPS-ja nuk parashikon të nxjerrë materiale të tjera
3 përveç atyre që cekëm më lart.

4 Kemi disa pyetje lidhur me këto. Ne kërkojmë parashtrime
5 nga ZPS-ja deri në ç'shkallë materialet që janë nxjerrë në
6 shtator, pasi u transferua çështja Trupi Gjykues, pra, deri në
7 ç'shkallë përmbajnë informacione të reja që nuk i janë nxjerrë
8 më përpara Mbrojtjes, sigurisht, krahasuar me versionet e reja
9 apo përkthimet e materialeve që janë nxjerrë më herët. Në fakt
10 i referohem poshtëshënimit 8 dhe 9 në parashtrimin 491 të
11 parashtrimit tuaj të protokolluar dhe paketës më të fundit të
12 materialeve të nxjerra 48 dhe 49 që nuk ka qenë pjesë e
13 parashtrimeve.

14 Gjithashtu, duam të na japi mendimin ZPS-ja sa i takon
15 parashtrimeve të Mbrojtjes për z. Januzi, bëhet fjalë për
16 dokumentin, pra, parashtrimin e protokolluar që është me numër
17 495, paragrafi 5 dhe 18, lidhur me kërkesën për të nxjerrë
18 disa materiale të caktuara edhe pse e ka refuzuar ZPS-ja këtë
19 gjë.

20 Nëse nuk e keni të qartë -- e keni të qartë z. Prokuror,
21 për çfarë e kam fjalën?

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, e kemi të qartë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull atëherë.

25 Z. Prokuror, a është nevoja të kalojmë në seancë private

1 apo mund të qëndrojmë në seancë publike për përgjigjen tuaj?

2 Z. HAFETZ: [Përkthim] Për përgjigjen e parë mund ta bëjmë
3 në seancë publike. Pastaj varet nga niveli i hollësive që do
4 të duhet t'ju jap, mbase do të duhet të kalojmë në seancë
5 private. Por pjesën e parë mund ta bëj në seancë publike.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
7 pikën e dytë, sa më e plotë që të jetë e mundur, sepse është
8 kërkesë edhe nga Mbrojtja kjo.

9 Atëherë, z. Prokuror, fjala është për ju.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Sa i takon pyetjes së parë dhe
11 materialeve të reja për të cilat sapo na pyetët, shumica, në
12 mos të gjitha, tashmë janë nxjerrë dhe po i rinxjerrim sipas
13 një rregulle të re të rregullores. Këtë thjesht për qëllime
14 njoftimi.

15 Sa i takon pyetjes së dytë, mendoj se është e rëndësishme
16 që të bazohemi në të njëjtat fakte, kjo ka qenë pjesë e
17 parashtrimeve tona edhe e kemi diskutuar edhe këtë *inter*
18 *partes* me njeri-tjetrin. Kështu që në qoftë se nuk jemi
19 sqaruar mjaftueshëm, mund ta bëjmë tani.

20 Dy pajisjet që janë gjetur, për të cilat Mbrojtësi i z.
21 Januzi kërkon që ZPS-ja t'i japë qasje, nuk janë në -- nuk i
22 kemi ne nga ana e ZPS-së këto pajisje. Por, shiko, mbase duhet
23 të kalojmë në seancë private sepse do të duhet të jap disa
24 hollësi lidhur me këtë aspekt.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Kalojmë në seancë private.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit. Në rregull.

16 Në këto momente kemi marrë propozimin nga Zyra e
17 Prokurorit të Specializuar që do të kontaktojë drejtpërdrejti
18 me Ekipet e Mbrojtjes për të diskutuar çështjet që kanë mbetur
19 pezull në mënyrë që të arrijnë një marrëveshje sa u takon
20 pyetjeve që duhen trajtuar më tej edhe, nëse do jetë nevoja,
21 që t'i kërkohet Trupit Gjygues që t'i lëshojë një urdhër
22 lidhur me hetim të mëtutjeshëm dhe lidhur me pyetjet që do të
23 na drejtohen.

24 Për momentin këtë po e lë me kaq. Sepse ne nuk kemi
25 ndonjë propozim konkret. Po e vlerësojmë komunikimin *inter*

1 *partes* edhe këtë frymë bashkëpunimi dhe shpresoj të vijojë
2 kështu sepse vetëm kështu mund të kemi një gjykim të shpejtë
3 dhe të drejtë, që është dhe në fund të fundit qëllimi kryesor
4 i yni.

5 Pika tjetër e radhës në rendin e ditës.

6 Trupi Gjykues i ka kërkuar Zyrës së Prokurorit të
7 Specializuar të na bëjë me dije nëse synon të nxjerrë, t'i
8 nxjerrë Mbrojtjes prova të mëtutjeshme shfajësuese sipas
9 rregullës 103 apo materiale ose prova sipas rregullës 102(3)
10 të Rregullores dhe, nëse po, për sa materiale bëhet fjalë dhe
11 kur. Gjithashtu i kërkuam ZPS-së të na thoshte nëse do të
12 kërkonte masa mbrojtëse për këto material apo prova dhe, nëse
13 po, kur.

14 Sa i takon kësaj pike. Z. Prokuror, i kemi marrë
15 parashtrimet tuaja sa i takon paketës së materialeve 42 dhe 44
16 dhe se materialet e reja shfajësuese të mundshme që do të
17 zbulohen do t'i jepen pa vonesë Mbrojtjes rast pas rasti.

18 Gjithashtu i kemi marrë parashtrimet tuaja sa i takon
19 rregullës 102(3) dhe rregullës 109(c) e Rregullores, germa (c)
20 e Rregullores. Tani do të donim që ZPS-ja të na bënte
21 parashtrime nëse ka ndonjë konstatim të mëtejshëm lidhur me
22 këtë aspekt.

23 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi asnjë parashtrim të
24 mëtutjeshëm lidhur me këtë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Po e lëmë me kaq për momentin atëherë.

2 Mirë. Trupi Gjykses i ka kërkuar parashtrime ekipeve të
3 Mbrojtjes nëse ata i kanë përfunduar hetimet e tyre. Nëse jo,
4 nëse parashikojnë të kenë hetime të tjera dhe me përfaqësi dhe
5 sa kohë do ju nevojitet për të përfunduar këto hetime.

6 Përpara se t'ua jap fjalën ekipeve të Mbrojtjes, dua të
7 rikujtoj çfarë thashë në fillim të seancës. Sa i takon kuadrit
8 të kufizuar të kësaj lënde gjyqësore. Procesi ka një vit që ka
9 filluar për z. Januzi dhe z. Bahtijari dhe dhjetë muaj tashmë
10 për z. Shala. Ndërkohë të akuzuarit janë në paraburgim.

11 Prandaj në këtë fazë të procesit gjyqësor, Trupi Gjykses do të
12 vlerësojë parashikime konkrete sa i takon përfundimit të
13 hetimit nga ana e Mbrojtjes në mënyrë që të sigurohemi që ky
14 gjykim të kryhet sa më shpejt.

15 Nëse është nevoja të kalojmë në seancë private për
16 parashtrimet tuaj, ju lutem na informoni paraprakisht.

17 Sa u takon parashtrimeve, shkurtimisht, marrim parasysh
18 që Mbrojtja e Shalës na ka thënë se hetimet janë në vazhdimësi
19 dhe se nuk është në pozicion Mbrojtja të na thotë tani
20 konkretisht dhe sa kohë do t'i nevojitet për t'i përfunduar
21 këto veprimtari hetimore.

22 Sa i takon Mbrojtjes së Bahtijarit, po ashtu shkurtimisht
23 vërejmë se hetimet janë po ashtu në vazhdimësi -- më falni, ju
24 kërkohet ndjesë. Ekipi i z. Bahtijari na ka thënë që është gati
25 afër fundit të hetimeve. Mund të nevojitet edhe rreth një

1 muaj. Dhe kemi marrë listën e dëshmitarëve të premtën e
2 shkuar, konkretisht në parashtrimin e protokolluar 502.

3 Sa i takon Mbrojtjes së Januzit, vërejmë se na ka
4 njoftuar se do të kryen hetime të mëtejshme. Edhe po ashtu
5 jemi njoftuar se hetimet në terren pritet të përfundojnë më 11
6 nëntor dhe disa shqyrtime digjitale. Nejse, nuk po jap shumë
7 hollësi lidhur me këtë se këto ishin dy pika që i kemi marrë
8 në parashtrimet me shkrim.

9 Mbrojtja e z. Shala, bazuar me informacionin që keni
10 tani, aktualisht, a mund të na thoni dhe sa kohë mund t'ju
11 nevojitet për të përfunduar hetimet.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Patjetër. Në kohën kur dorëzuan
13 parashtrimet me shkrim ne fillimisht donim të evidentonim ose
14 të kuptonim çfarë do të diskutohej sot që të kuptonim ne se
15 çfarë hetimesh do na duheshin më tej. Hetimet do të
16 përfundojnë brenda 11 nëntorit në mënyrë që të fillojë
17 gjykimi.

18 Pastaj, në varësi të provave që do të paraqesë
19 Prokuroria, mund të ketë një ndryshim të hetimeve tona, mund
20 të bëjmë hetime të mëtutjeshme. Por, brenda 11 nëntorit, ne do
21 ju njoftojmë lidhur me dëshmitarët që synojmë të thërrasim.
22 Mund t'ju them që z. Shala do të ketë provat e veta dhe do t'i
23 japë dhe nuk do të ketë më shumë se tri a katër dëshmitarë,
24 dëshmitarë shumë të shkurtër këta që do të thirren, dhe një
25 prej tyre do të jetë dëshmitar ekspert. Rast pas rasti do t'ju

1 njoftojmë lidhur me pozicionin tonë sepse do të jetë dhe në
2 varësi të provave që do të paraqesë edhe Prokuroria. Kuptohet
3 dhe është dhe në varësi të komunikimeve *inter partes*, të
4 zhvillimeve që do të kemi, por nuk presim që të kërkojmë
5 shtyrje të afatit pas 11 nëntorit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit, z. Cadman. Informacion goxha i dobishëm.

8 Mbrojtja e z. Bahtijari, a dëshironi të shtoni diçka
9 tjetër përveç asaj që thashë unë në përmbledhjen time?

10 ZNJ. GERRY [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit,
11 jo. Edhe ne synojmë deri më 2 nëntor. Shumë prej parashtrimeve
12 do t'i japim me shkrim sepse mendojmë se kështu do të jetë më
13 efikase. Pra, sa i takon parashtrimeve me shkrim, ne i kemi
14 dhënë disa emra gjykatësve dhe besojmë që lista e plotë e
15 dëshmitarëve nga ana jonë do të dorëzohet deri më 2 nëntor.
16 Shpresoj që të mos kemi zhvillime të tjera dhe shpresojmë që
17 do përfundojmë me hetimet deri më 11 nëntor. Në fakt jemi
18 shumë besimplotë që do përfundojmë deri më 11 nëntor.

19 Këto i them të gjitha lidhur me çështjet -- duke
20 përjashtuar çështjet që kanë të bëjnë me prova mjekësore, të
21 cilat nuk i propozoj për t'u përmendur në qoftë se ju nuk më
22 kërkonit që t'i propozoj ato.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
24 thatë, përmendët datën 2 nëntor që i takon, që është e shtunë.
25 Thjesht dua ta sqaroj se unë në fakt i pashë të gjitha

1 parashtrimet në mënyra të tillë që të shikoja datat përkatëse,
2 megjithatë data 2 nëntor është afati që ju keni përcaktuar për
3 z. Bahtijari, apo jo?

4 ZNJ. GERRY [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. Është
5 afat që e kemi caktuar për veten tonë ne. Dhe për këtë arsye
6 unë thashë që mbase mund të ketë pak lëshime të vogla,
7 megjithatë pozicioni ynë është që deri më datë 11 nëntor ne do
8 kemi parashtruar të gjitha dokumentet e nevojshme.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 ZNJ. GERRY [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju kërkoj
12 ndjesë se ndoshta nuk isha shumë e qartë dhe kishte
13 mospërputhje.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
15 ka asgjë për të kërkuar falje, kështu që jemi në rregull.

16 Mbrojtja e z. Januzi, unë vërej që hetimet tuaja
17 përfshijnë gjithashtu edhe disa shqyrtime të ekspertëve lidhur
18 me provat. Ne këtë aspekt e kemi diskutuar përpara dhe do ketë
19 gjithashtu edhe një diskutim *inter partes* pjesërisht për këtë
20 aspekt. Megjithatë tani dua t'ju pyes se sa kohë, sepse po
21 parashikoni gjithashtu edhe hetime të tjera ekspertësh, kështu
22 që lidhur me këtë pikë dëshiroj t'ju pyes sesa kohë do marrin
23 hapa të tillë hetimorë?

24 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Përpara se t'i
25 përgjigjem kësaj pyetje tuajën, dua që të them diçka lidhur me

1 qëndrimin e ZPS-së dhe pyetjes për aspektet e mbetura dhe në
2 qoftë se ne jemi gati për fillimin e gjyimit?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
4 lejoni një çast se do lexoj dhe një herë tjetër atë çfarë
5 thatë, pra, thjesht për ta kuptuar më mirë pyetjen tuaj më
6 duhet ta lexoj dhe një herë atë çfarë thatë. Ju thoni që:

7 "Doni që të komentoni diçka lidhur me qëndrimin e ZPS-së
8 edhe pyetjet që kanë të bëjnë me aspektet e mbetura përpara
9 sesa të fillojë gjykimi?"

10 Unë apo ne, si Trupi Gjygues, dëshirojmë të dimë se kur
11 jeni gati ju si ekip për të filluar gjykimin.

12 Ju lutem më dëgjoni deri në fund. Do t'ju jap fjalën pasi
13 të kem përfunduar. Na thoni se sa kohë do ju duhet, sa kohë
14 parashikoni që të bëheni gati për gjykim?

15 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, e kuptoj.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
17 t'jua jap fjalën.

18 Atëherë në qoftë se mendoni se do t'i ktheheni ose në
19 qoftë se do jepni një përgjigje për qëndrimin e ZPS-së dhe në
20 qoftë se kundërpërgjigjja juaj do jetë me vlerë për të na
21 ndihmuar ne, si anëtarë të Trupit Gjygues, se kur jeni gati ju
22 për gjykimin atëherë do ta lejojë këtë pyetje, në të kundërtën
23 vazhdoni me pyetjen e radhës.

24 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të nderuar
25 Gjykatës, po, e vërtetë është. Në fakt, sepse e mendoj që

1 përgjigja ime ndihmon për pyetjen që sa më bëtë në fund.

2 Parashtrimi me shkrim që ZPS-ja ka dorëzuar përpara kësaj
3 seance përgatitore për çështjen në paragrafin 3, ku thuhet që
4 ato parashikojnë ofrimin e provave të tjera. Dhe bëhet fjalë
5 për tri materiale në veçanti.

6 Dhe materiali i datës, nën paragrafin 2, duket në mënyrë
7 të arsyeshme i shkurtër. Dhe nuk është se jam i shqetësuar për
8 këtë material. Por sa i takon dy aspekteve të tjera, dy
9 materialeve të tjera, këto janë aspekte të cilat mund të
10 kërkojnë hetime të tjera të mëtejshme prej nesh dhe mund të
11 lidhen me çështjen e dëshmisë së një eksperti potencial.
12 Atëherë materiali i parë ka të bëjë me raporte që ZPS-ja ka
13 marrë nga institucione forenzike të jashtme duke analizuar të
14 dhënat e sekuestruara nga tri telefonat e të tri të akuzuarve.
15 Ndërkohë që materiali i tretë ka të bëjë me të dhëna që janë
16 brenda qelive dhe që kanë të bëjnë me përdorimin e hartave.

17 Kështu që për këtë arsye është e rëndësishme që të
18 sqarohen këto tri materiale dhe kam përshtypjen që kjo do të
19 japë ndihmën e vet, domethënë, shtjellimi i mëtejshëm i këtij
20 aspekti do ju ndihmoj juve dhe kjo do të na e bëjë më të qartë
21 neve sesa kohë na duhet për hetimet.

22 Kështu që dëshiroj t'i kërkoj Trupit Gjykues që t'i
23 pyesë, ta pyesë Prokurorinë dhe të shprehet se kur do të marrë
24 provat dhe kur parashikojnë që këto materiale do të na jepen
25 neve.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, avokat. Por herën tjetër, ju lutem, mos më
3 ndërprisni ndërkohë që do jem duke folur unë.

4 Pasi e them këtë, i kërkoj ZPS-së që t'i japë përgjigje,
5 por megjithatë, pavarësisht kësaj, domethënë, pavarësisht
6 pyetjes që ju na kërkuat që t'i bënim Zyrës së Prokurorisë a
7 mund të na thoni ju lutem sesa kohë ju duhet që të përfundoni
8 me hetimet tuaja?

9 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Organi i dytë
10 që e ka bërë të vështirë për ne për të dhënë një përgjigje të
11 drejtpërdrejtë për këtë pyetje është Zyra Administrative.

12 Sepse në fillim fare të kësaj seance, e nderuar
13 Gjykatëse, ju i ftuat të gjitha palët - jo vetëm ZPS-në dhe
14 Ekipet e Mbrojtjes, po gjithashtu ftuat edhe Zyrën
15 Administrative - që të punonte në mënyrë bashkëpunuese me
16 palët e tjera, në mënyrë të tillë që gjykimi mund të fillojë
17 sa më shpejt të jetë e mundur. Unë ju bashkohem ju, të nderuar
18 Gjykatës, që i bëni thirrje të gjithë kolegëve të mi,
19 domethënë, nga ZPS-ja, po edhe Ekipet e Mbrojtjes, po
20 gjithashtu edhe Zyra Administrative do të duhet që të
21 përfshihet në këtë përpjekje.

22 Më duhet të them që gjatë përvojës time, nuk më ka
23 ndodhur asnjëherë një rast ku seanca përgatitore për
24 zhvillimin e çështjes ka qenë kaq shumë e vështirë dhe kaq dhe
25 nuk më ka ndodhur asnjëherë në përvojën time që çështjet e

1 financimit të kenë qenë kaq penguese dhe kaq të vështira e të
2 komplikuara sa në këtë rast.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Avokat, nuk do të kalojmë tek kjo pikë. Por thjesht dua të më
5 thoni në qoftë se është e mundur që të informoni Trupin
6 Gjykes sa i takon përfundimit të hapave hetimorë të ekipit
7 tuaj.

8 Ne jemi në dijeni të diskutimeve që kanë ndodhur. Unë nuk
9 dua që këto diskutime të përsëriten dhe një herë tani në
10 sallën e gjyqit sepse dëshiroj që kohën këtu ta përdorim për
11 t'u përqendruar tek ajo çfarë duhet të bëjmë. Dhe ajo çfarë
12 duhet të bëjmë ne është që duhet ta përgatisim këtë çështje,
13 këtë lëndë gjyqësore për fillim gjykimi. Unë i kam lexuar
14 parashtrimet tuaja, i kam ndjekur konsultimet dhe shkëmbimet
15 që kanë ndodhur. Megjithatë, për momentin, për mua është
16 absolutisht e rëndësishme të kuptoj se në çfarë pike jeni sa i
17 takon hetimeve dhe çfarë problemi apo pengese keni sa i takon
18 aspekteve të kohës.

19 Në qoftë se ka ndonjë një gjë për të cilën ne duhet të
20 vendosim si Trup Gjykes, sigurisht që do ta bëjmë këtë gjë,
21 megjithatë nuk na ndihmon në qoftë se ju do përsërisni dhe
22 këtë jua them me gjithë respektin, Avokat. Domethënë, nuk ja
23 vlen që të përsërisni dhe një herë këtë pjesë të diskutimit.
24 Unë tani dua të di prej jush se çfarë ju nevojitet për të
25 përfunduar hetimet tuaja.

1 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të nderuar
2 Gjykatës, ne duam që Zyra Administrative të pajtohej që ne të
3 mund të udhëtojmë dhe të bëjmë hetimet tona.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
5 kalojmë në seancë private.

6 Ju lutem, Sekretare, na kaloni në seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 jemi në seancë publike.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Mbrojtësi i z. Shala, e shikoj që doni të merrni fjalën,
14 megjithatë përpara sesa t'ju jap fjalën, do të bëj një koment
15 dhe pastaj do t'ju jap fjalën.

16 Mbrojtja e z. Januzi, deri tani kemi qenë në seancë
17 private, megjithatë për tani vërej se ju nuk jeni në gjendje
18 që të jepni një informacioni sa i takon përcaktimit të kohës
19 që do ju nevojitet për të përfunduar hetimet, sepse ju duhet
20 së pari që të merrni materiale nga ZPS-ja. Megjithatë do thoja
21 që ju i vazhdoni, domethënë, do vazhdoni me hapat hetimorë në
22 terren, pra, do bëni hetime në terren që do t'ju marrin pak a
23 shumë pesë ditë.

24 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, e saktë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne

1 diskutuam se Zyra Administrative tha gjatë seancës private që
2 ka fonde të disponueshme për të gjitha ekipet e Mbrojtjes në
3 një sasi të caktuar parash në mënyrë të tillë që mund të
4 lejohen hetimet e ekspertëve. Dhe këto para mund të përdoren
5 për çdo lloj hetimesh për të cilat juve ju duhet që të
6 angazhoheni.

7 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E kuptojmë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Thjesht po bëj një përmbledhje të diskutimeve që u mbajtën në
10 seancë private. Nuk po ju jap fjalën për të thënë diçka ose
11 për të shtuar. Por është e rëndësishme që pjesë e diskutimit
12 që ne patëm gjatë seancës private të mund të ndahet me
13 publikun. Dhe një pjesë e diskutimeve tona mund të bëhet edhe
14 në publik, ndërkohë që aspekte të caktuara duhet të trajtohen
15 në seancë private. Pra, kjo thjesht ishte një përmbledhje në
16 mënyrë të tillë që të mund të ndjekin zhvillimet e procesit
17 personat ose publiku që na ndjek.

18 Z. Rees, propozoj që ju të dorëzoni kërkesën tuaj për
19 Zyrën Administrative sa i takon financimeve, pra, do ju
20 kërkoja që këtë kërkesë ta bëni sa më shpejt që të jetë e
21 mundur, sepse kjo është diçka që besoj që mund të bëhet dhe
22 sot, nuk është e nevojshme që të presim për nxjerrjen e
23 provave për Ekipet e Mbrojtjes për ju për të pasur mundësi për
24 të bërë kërkesën.

25 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të nderuar

1 Gjykatës, qëndrimi ynë është që Zyra Administrative duhet të
2 kërkojë që të paraqesë një plan veprimtarish, përfshirë këtu
3 edhe atë çfarë ne synojmë që të bëjmë në lidhje me hetues ose
4 me hetime të jashtme të pavarura. Ne na duhet që të marrim
5 miratimin paraprak. Nuk ka ndonjë problem me këtë, e kuptojmë
6 dhe nuk është se jemi kundër kësaj. Megjithatë, kjo na kërkon
7 ne që ne të kontaktojmë me ekspertin, që ai të na japë një
8 kuatim të punës së bërë, domethënë, sa para bën puna e bërë.
9 Ndërkohë që ZPS-ja po na tregon që pas shtatë ditësh do të na
10 japë ca dokumente, materiale të tjera që kanë të bëjnë me
11 telefonin.

12 Të nderuar Gjykatës, nuk është se po përsëris atë çfarë
13 thamë, po thjesht dua ta kuptoni se ne si pjesë e Mbrojtjes
14 dëshirojmë që duhet që t'i shikojmë vetë materialet në mënyrë
15 të tillë që të vlerësojmë çfarë natyre kanë ato, dhe në mënyrë
16 të tillë që të dimë se në çfarë mase kanë ndikim këto
17 materiale mbi ne. Pra, kolegu tha që do të na jepet ky
18 material brenda shtatë ditësh.

19 Ndërkohë që sikurse jua thashë edhe në seancë të mbyllur,
20 ne do ta shikojmë menjëherë përmbajtjen e këtij informacioni.
21 Do vlerësojmë se çfarë pune nevojitet prej nesh. Do vlerësojmë
22 gjithashtu që çfarë do duhet t'i kërkojmë ekspertit. Dhe
23 menjëherë atëherë do t'i kërkojmë Zyrës Administrative që të
24 na japë miratimin e vet. Pra, ne do ta bëjmë këtë në mënyrë të
25 tillë që të mund të vazhdojmë sa më shpejt të jetë e mundur me

1 gjykimin siç kemi bërë deri tani.

2 Të nderuar Gjykatës, në një fazë të mëvonshme pastaj ne
3 nuk mund të kërkojmë një miratim tjetër, por sepse kjo do
4 ishte në kundërshtim me udhëzimet për administrimin e ndihmës
5 juridike falas. Nuk mund të jepet asnjë shërbim, në qoftë se
6 nuk ka një kontratë të nënshkruar.

7 Megjithatë ne jemi këtu ku jemi. Jemi të angazhuar që
8 këto hapa të mund t'i ndërmarrim sa më shpejt të jetë e mundur
9 dhe duhet që ne të marrim këto materiale së pari.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit. Ju ndëgjuaam një herë. Nuk ka nevojë të
12 përsëritni atë që e thatë. Ju lutem të mos merrni kohë pa
13 nevojë të kohës së Gjykatës.

14 Në rregull. Do të kalojmë tek pika tjetër e rendit të
15 ditës, që është pika D.

16 Po, më fal, Avokat i z. Shala, ju harrova. Kërkoj ndjesë.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk dua që ta zgjas këtë diskutim
18 më shumë sesa është e nevojshme. Shkurtimisht, z. Rees ka të
19 drejtë kur thotë që atë që e kemi në dispozicion faktikisht
20 nuk ka qenë e qasshme për Mbrojtjen, ne nuk kemi qenë në
21 gjendje të kemi qasje në *hard drive* e kompjuterit, ka shumë të
22 dhëna në atë sistem dhe mund të ndodhë që të mos ketë një
23 licencë apo të drejtë për qasje në atë dosje.

24 Dhe për atë arsye duhet që Mbrojtja të pajiset me të
25 drejtë apo licencë të tillë në mënyrë që të ketë qasje në ato

1 *hard drive* për të parë se çfarë përmbajnë ato, për këtë
2 ndoshta do të na duhen edhe udhëzimet e ekspertit.

3 Prandaj kërkesa ime është kjo, në qoftë se duhet një
4 licencë për një gjë të tillë, atëherë ajo t'ju jepet ekipeve
5 të Mbrojtjes. Në qoftë se nuk duhet, atëherë ZPS-ja të na
6 mundësojë këtë qasje në materialet në ato *hard drive*.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur e
8 keni marrë këtë material?

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Kemi marrë materiale të tilla në
10 momente të ndryshme. Na është dhënë informacioni në lidhje me
11 një *hard drive* sot.

12 Dhe kemi ekspertët tanë që mundohen të kenë qasje në
13 materialin e tillë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Prokuror, kur ju është dhënë kjo qasje Mbrojtjes, a e dini?

16 Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk kam informacionin e saktë. Por
17 jam pak i habitur se pse ngrihet kjo çështje. Mund t'jua jap
18 më vonë datat e sakta.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
20 t'i ftoj palët që në seancë gjyqësore të mos futemi në
21 aspektet teknike. Meqë ka, ekziston mundësia e diskutimeve
22 ndërmjet palëve, unë nuk e shoh të arsyeshme se pse kjo temë
23 diskutohet tani në sallë të gjyqit, kjo ka mund të bëhet në
24 kuadër të bashkëpunimit midis palëve.

25 Prandaj do ta përfundoj këtu dhe do t'ju kërkoj palëve që

1 të organizohen në këtë drejtim. Besoj që këtu duhet të
2 përfundojë diskutimi.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Ky është një material që është
4 nxjerrë para një kohe dhe këto janë çështje që i kemi ngritur
5 me ZPS-në edhe më herët. Jemi përpjekur që ta zgjedhim këtë
6 problem në frymën e bashkëpunimit midis palëve.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Shoh se dikush e ka ngritur dorën nga Mbrojtja e z.
10 Bahtijari. Keni fjalën.

11 ZNJ. GERRY [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Shkurtimisht,
12 unë kam shkarkuar *Cellebrite* programin. E kam njoftuar ZPS-në.
13 Mund të ndodhë që kompjuterët që ju janë dhënë avokatëve të
14 Mbrojtjes nuk mund ta kenë kapacitetin e nevojshëm për këtë
15 program.

16 Ne po përpiqemi në qoftë se, për shembull, mund të na
17 jepen kompjuterë më të mirë në zyrë, atëherë do të kishim
18 preferuar një zgjidhje të tillë.

19 Softueri që na është dhënë ka bërë shkarkimin e
20 materialit.

21 Thjesht këtë e përmendi për t'i ndihmu palët.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Edhe këto të dhëna teknike janë mjaft të dobishëm por nuk
25 do të kisha dash që të shpenzojmë kohën e seancës për këtë.

1 Këtë informacion mund ta ndani me kolegët dhe me personat
2 përkatës në ambientet e Gjykatës në mënyrë që të gjendet
3 zgjidhja e nevojshme.

4 Askush tjetër nuk ka ngritur dorën. E shoh.

5 Atëherë pika tjetër me radhë. Trupi Gjykues ju ka kërkuar
6 Ekipeve të Mbrojtësve që të tregojnë, të shprehen se kur do të
7 paraqesim provat dhe duhet t'i ndryshojmë në dosjet
8 paragjyqësore dhe do t'i dorëzojmë listat e dëshmitarëve të
9 mundshëm.

10 Sa i përket Mbrojtjes së z. Shala, në parashtrimin tuaj
11 ju kërkoni që të përditësoni Trupin Gjykues në lidhje me
12 nevojën e nxjerrjes së provave, nevojën e ndryshimit të dosjes
13 së paragjyqësore dhe listën e dëshmitarëve.

14 A doni që të mbetemi në seancë private apo publike?

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Mund të mbetemi në seancë publike.

16 Unë në parashtrimet me shkrim kam theksuar se çfarë janë
17 kërkesat apo kriteret në lidhje me nxjerrjen e materialeve. Në
18 këtë fazë nuk kemi marrë vendim në qoftë se duhet të dorëzohet
19 një dosje paragjyqësore e ndryshuar.

20 Por në parashtrime kemi theksuar këtë si mundësi, në
21 varësi të asaj se çfarë do të ndodhë në diskutimet e sotçme,
22 domethënë, në qoftë se ka ndryshime që të mund të ndryshohet
23 edhe dosja paragjyqësore.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

25 Po e lexoj këtu në parashtrimin tuaj:

1 "Mbrojtja mund të presë që të ndryshojë dosjen e vet
2 paragjyqësore dhe listën e dëshmitarëve potencialë. Dhe do të
3 jepet informacion i përditësuar në konferencën përgatitore."

4 Prandaj dhe ju kërkova që të bëni këtë përditësim.

5 Z. CADMAN: [Përkthim] Atë që mund ta themi me siguri, siç
6 e kam theksuar edhe më herët, është ndoshta dorëzimi i një
7 shtojce ndaj dosjes paragjyqësore apo plotësimi në qoftë se
8 është e nevojshme dhe dorëzimi i listës së dëshmitarëve
9 potencialë para datës 11 nëntor.

10 Sigurisht që nuk jemi në pozitë sot që t'i paraqesim ata
11 dëshmitarë në listë mirëpo këtë do ta bëjmë para datës 11
12 nëntor.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Singerisht unë kam pritur një informacion më të gjerësishëm të
15 përditësuar prej jush sot, mirëpo do ta mbaj parasysh këtë që
16 e thatë për momentin.

17 Mbrojtësja e z. Bahtijari, Trupi Gjykses ka marrë
18 parasysh parashtrimet tuaja dhe kemi këto pyetje për ju: A
19 keni ndërmend të paraqitni prova? A parashikoni se do të jetë
20 e nevojshme të ndryshoni dosjen tuaj paragjyqësore tashmë të
21 përditësuar dhe kemi marrë listat e dëshmitarëve apo listën e
22 dëshmitarëve që nuk është përfundimtare, por kemi marrë një
23 listë të tillë javën e kaluar.

24 Dhe përveç këtyre pyetjeve për nxjerrjen apo paraqitjen e
25 provave dhe ndryshimin e dosjes paragjyqësore, a mund

1 gjithashtu të na jepni një shpjegim apo sqarim në lidhje me
2 parashtrimet që keni bërë për nevojën e paraqitjes së
3 parashtrime në seancë private, është në paragrafin 494 -- më
4 falni, në paragrafi 11 të parashtrimeve.

5 ZNJ. GERRY [Përkthim] Vetëm një sekondë ta gjej atë
6 paragraf.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
8 dua ta lexoj me zë, por mund të futemi në seancë private për
9 të dhënë përgjigje në këtë pyetje.

10 Por dy pyetjet e tjetra mund t'i bëni në këtë seancë
11 publike. Urdhnoni.

12 ZNJ. GERRY [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Sa i përket
13 nxjerrjes së materialeve, kemi kontakti Prokurorinë në lidhje
14 me faktet për të cilat janë dakord në lidhje me incizimet e
15 nxjerra nga telefonat.

16 Ndoshta dhe disa përmbajtje tjera mund të jenë objekt i
17 marrëveshjeve. Për shembull, në qoftë se klienti jonë në prill
18 2023 ka kërku të shikojë parashikimin e motit në *Google* dhe jo
19 përmbajtje të tjera.

20 Ne gjithsesi nuk presim që ta ndryshojmë apo plotësojmë
21 dosjen paragjyqësore. Kemi bërë tre ndryshime dhe plotësime
22 deri tani. Ka edhe disa gjëra që kanë mbet të pazgjidhura dhe
23 do t'i trajtojmë ato në seancë private. Dhe këto kanë të bëjnë
24 kryesisht me shëndetin e z. Bahtijari.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Atëherë do të kalojmë në seancë private për të sqaru këtë
2 pikë.

3 ZNJ. GERRY [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kam gjë
4 tjetër për të thënë në këtë moment.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
6 kalojmë në seancë private, ju lutem.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Tani do t'i jap fjalën apo do t'i drejtohem z. Januzi.
2 Nga parashtrimet tuaja del qartë që ju nuk jeni në gjendje të
3 tregoni se kur do të jeni të gatshëm të jepni një informacion
4 se kur do të nxirrni provat, të ndryshoni dosjen paragjyqësore
5 dhe dorëzoni listën e dëshmitarëve potencialë. A keni diçka
6 për të shtuar përveç asaj që keni thënë deri tani?

7 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. Ne kemi
8 thënë dhe i qëndrojmë asaj që kemi thënë, se me kusht që çdo
9 gjë të zhvillohet dhe të shkojë si duhet, ne planifikojmë që
10 t'i përfundojmë hetimet në terren deri më datën 11 nëntor. Në
11 qoftë se kjo ndodh, atëherë zotohem që do të dorëzojmë dosjen
12 paragjyqësore të përditësuar dhe listën e dëshmitarëve të
13 mundshëm deri më datën 19 nëntor. Besoj që ky informacion t'ju
14 ndihmojë për planifikim.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, Mbrojtës i Specializuar.

17 Përpara se të vazhdojmë, Trupi Gjygues nënvijëzon se
18 parashikon që në qoftë se ZPS-ja, dhe këtë duhet ta diskutojmë
19 këtë më pas, pas pushimit, në qoftë se ZPS-ja do të jetë në
20 gjendje të përfundojë me paraqitjen e provave të veta në
21 nëntor 2024 dhe do t'i diskutojmë më me hollësi mundësitë e
22 datës së fillimit dhe përfundimit të paraqitjes së provave të
23 ZPS-së dhe do të bëhet ky diskutim në kuadër të pikës që ka të
24 bëjë me zhvillimin e gjykitimit pas pushimit.

25 Pra, në qoftë se ZPS-ja do të përfundojë me fazën e

1 paraqitjes së provave të veta në nëntor të vitit 2024, atëherë
2 paraqitja e provave prej ekipeve të Mbrojtjes mund të fillojë
3 në dhjetor të vitit 2024 me kusht, dhe këtë e theksoj në
4 përputhje me parashtrimet e Mbrojtjes me kushtin në varësi,
5 pra, të vendimeve si mbas rregullës 130 të Rregullores.

6 Pra, ju kërkoj ekipeve të Mbrojtjes që të përgatiten duke
7 e pasur këtë planifikim të datave në kokë. Ekipet e Mbrojtjes
8 ftohen që të konsultohen se kush do ta bëjë paraqitjen e
9 provave i pari si ekip. Në parim këtë mund t'ua lëmë ekipeve
10 Mbrojtëse që të merren vesh. Dhe nëse nuk merren vesh,
11 vendimin do ta bëjë Trupi Gjykses. Por këtë, sikur e thashë,
12 do ta diskutojmë më pas.

13 Kemi dhe një pikë të fundit në lidhje me seancat *ex parte*
14 të mbyllura.

15 Kemi marrë parashtrimet e palëve dhe i mbajmë parasysh
16 dhe mendoj se nuk ka nevojë që t'i diskutojmë në këtë moment
17 më tej.

18 Atëherë jemi disa minuta para orës 11.00. Dhe mendoj që
19 është një moment i përshtatshëm për ta bërë pushim prej 30
20 minutash. Atëhere shihemi në orën 11.30.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 --- Pauza fillon në orën 10.53

23 --- Seanca rifillon në orën 11.30

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
25 se u kthyet mbas pushimit.

1 Edhe një herë ju lutem të prezantohen palët ose më saktë,
2 nëse nuk ka ndryshime, mjaft të thoni "s'ka ndryshime".

3 Z. Prokuror, fillojmë me ju.

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Janë të gjithë të pranishëm
5 personat që ishin paradite, me përjashtim të Prokurores së
6 Specializuar.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra
8 Administrative.

9 Z. NILSSON: [Përkthim] Nuk ka ndryshime nga ana e Zyrës
10 Administrative.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Ekipet e Mbrojtjes? Mbrojtja e z. Shala?

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk ka ndryshime.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mbrojtja e z. Bahtijari.

16 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk ka
17 ndryshime.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
19 Mbrojtja e z. Januzi, fjala është për ju.

20 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk ka
21 ndryshime.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
23 rregull.

24 Vazhdojmë me pikën tjetër në rendin e ditës që është
25 zhvillimi i procesit gjyqësor. Ka disa pika këtu dhe do t'i

1 marr një për një.

2 Pika e parë është fillimi i gjykimit dhe deklaratat
3 hyrëse.

4 Trupi Gjykses i ka marrë parashtrimet e palëve sa i takon
5 datës për fillimin e gjykimit. E kemi marrë parasysh
6 parashtrimet -- i kemi marrë parasysh parashtrimet. ZPS-ja
7 është gati të fillojë më 11 nëntor 2024.

8 Mbrojtja e z. Shala dhe z. Bahtijari nuk janë kundër
9 datës 11 nëntor 2024 për fillimin e gjykimit.

10 Kemi marrë parashtrime nga Mbrojtja e z. Januzi, po
11 ashtu, i cili na tha të martën, më 1 tetor, se nuk kishte
12 asnjë parashtrim për të bërë sa i takon 11 nëntorit për
13 fillimin e gjykimit. Morëm një email të enjten, më 3 tetor, se
14 Mbrojtja e Januzit mbase do kërkojë një datë alternative për
15 deklaratat hyrëse të Prokurorisë për shkak se avokati ka një
16 angazhim tjetër më 11 dhe 12 nëntor 2024. Të premtën morëm --
17 të premtën, më falni, morën një email, më 4, në orën 12.47 ku
18 Mbrojtja e z. Januzi na kërkoi që Prokuroria të fillonte
19 deklaratat hyrëse më 13 nëntor për shkak të angazhimeve të
20 tjera.

21 Faleminderit për parashtrimet. Marr parasysh se ZPS-ja
22 është gati ta fillojë gjykimin në nëntor 2024, dhe që të
23 shfrytëzojmë sa më shumë sallën e gjyqit, Trupi Gjykses synon
24 që të fillojë gjykimi më 8 nëntor, dhe u kërkon palëve të jenë
25 të disponueshëm atë ditë për deklaratat e tyre hyrëse. Edhe në

1 qoftë se nuk do të jenë vetë mbrojtësit, le të jenë
2 bashkëmbrojtësit të pranishëm nëse, sigurisht, nëse
3 kryembrojtësi nuk do të jetë i disponueshëm.

4 Më tej, Trupi Gjykses synon ta përdorë gjithë javën 11
5 deri më 15 nëntor për seanca dhe ju kërkon palëve të jenë të
6 disponueshme atë javë.

7 Do të flasim pak më gjatë e gjerë për këtë në seancë
8 private ose publike, si të jetë nevoja. Por, deri tani kjo
9 lidhet me fillimin e gjykimit, deklaratat hyrëse dhe madje të
10 fillojmë edhe me dëshmitarët, pse jo. Të paktën ky është
11 parashikimi aktual.

12 Do diskutojmë dhe ca aspekte të tjera dhe mund t'i
13 rikthehem propozimit që bëri Trupi Gjykses për fillimin e
14 gjykimit.

15 Trupi Gjykses udhëzoi ekipet e Mbrojtjes nëse -- të na
16 thonë nëse janë kundër që ZPS-ja të lexojë një përmbledhje të
17 aktakuzës në fillim të paraqitjes së provave, që të mos
18 lexohet e gjithë aktakuza. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e
19 Shalës dhe Bahtijarit nuk janë kundër përmbledhjes, por
20 Mbrojtja e z. Januzi do të shohë paraprakisht një kopje, në
21 mënyrë që ta japi pastaj kundërshtimin e vet nëse do të ketë.

22 Z. Prokuror, fjala është për ju. Nuk e di nëse keni për
23 t'i thënë diçka Mbrojtjes së z. Januzi lidhur me këtë pikë.

24 Z. DEVANEY: [Përkthim] Shkurtimisht. E kemi parasysh
25 qëndrimin e Mbrojtjes. Do ta shqyrtojmë me njëri-tjetrin dhe

1 do ta kontaktojmë përkatësisht.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
3 mund të jeni pak më konkret?

4 Z. DEVANEY: [Përkthim] E kuptojmë kërkesën, do ta
5 vlerësojmë kërkesën. Nuk shohim asnjë problem. Mund t'ja japim
6 një kopje të përmbledhjes së aktakuzës. Ata mund ta bëjnë
7 kundërshtimin më pas kur të jetë momenti i duhur.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
9 mundësi tjetër, ndonëse është prerogative e ZPS-së të formulojë
10 akuzat, ne mund të lexojmë akuzat njësoj siç kemi bërë kur
11 është paraqitja fillestare. Ai tekst, mesa kuptoj unë, është
12 marrë fjalë për fjalë nga aktakuza e ndryshuar. Po ne nëse do
13 Mbrojtja e lexojmë dhe të gjithë aktakuzën, nuk ka asnjë
14 problem.

15 I marr parasysh komentet e ZPS-së në lidhje me këtë.

16 Z. DEVANEY: [Përkthim] Dhe ne e marrim parasysh
17 propozimin tuaj për të lexuar dokumentin që është lexuar gjatë
18 paraqitjes fillestare.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Avokati i z. Januzi, keni diçka për të thënë?

21 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Shpresoj që ta
22 keni mirëkuptuar propozimin tonë. Duam të shikojmë një
23 përmbledhje paraprakisht. Nuk kemi asnjë problem. Mjaft që të
24 biem dakord për formulimin. Në qoftë se Prokuroria nuk është
25 dakord atëherë ne do kërkojmë që të lexohet e gjithë aktakuza.

1 Pra, nëse Prokuroria do të lexojë një përmbledhje, le të na
2 japë një kopje paraprakisht dhe do ta diskutojmë ne me njëri-
3 tjetrin përmbajtjen e kësaj përmbledhje.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Teksti që është lexuar gjatë paraqitjeve fillestare dhe
6 paraprake, nuk ju mjafton?

7 Z. REES: [Përmes videolidhje] [Përkthim] Do të më duhet
8 ta shoh. Nëse ky është propozimi i Prokurorisë, atëherë do ta
9 shoh dhe do ju njoftim me shkrim nëse na mjafton apo nuk na
10 mjafton.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
12 marr parasysh komentin tuaj. Faleminderit. Do lëshojmë urdhër
13 lidhur me këtë dhe do të japim direktivat përkatëse kur të
14 nxjerrim urdhrin për zhvillimin e procesit gjyqësor.

15 Tani do trajtoj bashkë pikën C dhe D. I kemi kërkuar ZPS-
16 së dhe ekipeve të Mbrojtjes të na njoftojnë nëse synojnë të
17 bëjnë deklaratat hyrëse. Kjo është në bazë të rregullës 126(1)
18 i Rregullores.

19 I kemi marrë parasysh parashtrimet e palëve dhe nuk e po
20 zgjas më tej këtë pikë.

21 Gjithashtu, i kemi kërkuar Mbrojtjes të na njoftojë nëse
22 të akuzuar duan të bëjnë deklaratat jo nën betim. Sipas
23 rregullës 142(1) të Rregullores, dhe nëse duan t'i bëjnë këto
24 deklaratat, a duan t'i bëjnë në të njëjtën ditë që do të bëjë
25 deklaratat hyrëse Mbrojtja apo më vonë. I kemi marrë parasysh

1 parashtrimet e Mbrojtjes sa i takon këtyre deklaratave jo nën
2 betim dhe kur duan t'i bëjnë këto deklaratë, nëse do t'i
3 bëjnë. Faleminderit për parashtrimin.

4 Pika e dytë, është familjarizimi i dëshmitarëve përpara
5 se të japin dëshmi.

6 Kemi marrë parashtrimet tuaja lidhur me këtë aspekt.
7 Gjithashtu kemi marrë dhe parashtrimet e ZPS-së sa i takon
8 avantazheve që ka përgatitja e dëshmitarëve paraprakisht.
9 Vërej që Mbrojtja e Shalës nuk ka kundërshtim lidhur me
10 manualin për familjarizimin e dëshmitarëve që ka miratuar
11 Trupi Gjykses në Çështjen 04. Mbrojtja e z. Bahtijari tha që
12 do të ndjekë praktikën e përgjithshme, e zakonshme.

13 Dhe Trupi Gjykses dëshiron të theksojë sa i takon
14 parashtrimeve tuaja, Mbrojtja e z. Bahtijari, në paragrafin 20
15 të parashtrimit 494, të gjithë dëshmitarët që do të vijnë të
16 japin dëshmi në sallën e gjyqit duhet të bëjnë procesin e
17 familjarizimit nëse Trupi Gjykses vendos të adoptojë të
18 njëjtin qasje si më përpara.

19 Mbrojtja e z. Januzi nuk është shprehur lidhur me këtë
20 çështje.

21 Mbrojtja e z. Januzi, keni ndonjë gjë për të thënë në
22 lidhje me këtë.

23 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Zyra Administrative nuk ka asnjë parashtrim lidhur me
2 praktikën që ka ndjekur Trupi Gjykses në Çështjen 04 dhe 05.
3 Zyra Administrative gjithashtu ka dorëzuar si një shtojcë të
4 parashtrimeve të tyre manualin dhe udhëzimin e Zyrës për
5 Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Faleminderit për këtë.

6 Kalojmë tek pika tjetër, nëse nuk keni diçka për të
7 ngritur lidhur me pjesën e familjarizimit, të paktën nga
8 Mbrojtja apo ZPS-së.

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Po flasim për familjarizimin apo
10 përgatitjen?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Atëherë për familjarizimin nuk kam
13 asgjë për të shtuar.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po në
15 rast se kishit ndonjë paqartësi, Mbrojtja e z. Shala.

16 Prokuroria na ka bërë me dije se sa avantazhe ka fakti që
17 dëshmitarët duhen përgatitur paraprakisht. Besoj se e keni
18 parë edhe ju këtë gjë. Faleminderit.

19 Pika e tretë, që është prezantimi i dëshmive të
20 dëshmitarëve nga palët. Pika A, kemi udhëzuar ZPS-në të na
21 konfirmonte se lista e dëshmitarëve dhe koha e kërkuar për
22 pyetjet e veta për këtë dëshmitar dhe lista e provave
23 materiale janë përfundimtare. Pra, kemi kërkuar të na thonë
24 nëse janë përfundimtare.

25 I kemi marrë parasysh parashtrimet e ZPS-së. Vërejmë që

1 ZPS-ja e ka reduktuar kohën e parashikuar për pyetjet e
2 dëshmitarëve. Kemi parë versionin e redaktuar publik të
3 parashtrimeve tuaja, dhe pamë që i keni publikuar dhe numrin e
4 dëshmitarëve që synoni të thërrisni.

5 Desha t'ju pyesja nëse mund ta diskutojmë në seancë
6 private këtë, por mesa shoh mund ta diskutojmë në seancë
7 publike. Shumë mirë.

8 Kemi dy dëshmitarë në listë.

9 Sa i takon kohëzgjatjes së kohës apo kohëzgjatjes së
10 pyetjeve nga ana e -- ZPS-ja, e referoj Mbrojtjen e z.
11 Bahtijari tek shtojca e parashtrimeve që ka dorëzuar ZPS-ja.
12 Aty edhe kanë caktuar ata sesa kohë do ju nevojiten për
13 pyetjet e veta.

14 Z. Prokuror, a keni ndonjë parashtrim tjetër lidhur me
15 këtë aspekt?

16 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkurtimisht.

17 Lista e dy dëshmitarëve është përfundimtare, me kusht që
18 mund ta kuptoni dhe nga parashtrimi i protokolluar, po dua ta
19 them edhe këtu për procesverbal, sigurisht që ne kemi
20 prioritet efikasitetin, planifikimin. Ka disa prova që janë
21 diskutuar sot, që janë pjesë e listës së provave materiale dhe
22 Mbrojtja ka thënë që do t'i kundërshtojë mbi disa -- mbi
23 disa -- mbi disa baza. Edhe do të dorëzojmë edhe një
24 parashtrim për këtë dhe do të jenë goxha të hollësishme këto
25 parashtrime.

1 Në parashtrimin tonë të protokolluar kemi thënë që ne
2 synojmë brenda dy javësh t'i dorëzojmë Trupit Gjykses një
3 kërkesë për pranimin e disa prej këtyre provave. Janë prova
4 shkresore. Shumica janë prova që janë nxjerrë nga telefonat
5 celularë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Provueshmërinë e provave do ta trajtojmë më vonë në rendin e
8 ditës.

9 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po unë po e ngre tani për t'ju
10 përgjigjur pyetjes tuaj. Pra, unë po ju them që në qoftë se
11 ZPS-ja do të ketë nevojë për një dëshmitar shtesë apo më shumë
12 dëshmitarë për t'ju përgjigjur kundërshtimeve në mënyrë që
13 Trupi Gjykses të marrë vendim sa më të mirë, është e mundshme
14 që vetëm -- vetëm në rast të tillë do kërkojmë të shtojmë një
15 ose dy dëshmitarë. Po ju njoftoj paraprakisht.

16 Se mocioni që të bëjmë brenda dy javësh do të mjaftojë
17 dhe mbase nuk do jetë nevoja të thërresim dëshmitarë këtu në
18 sallën e Gjyqit, po unë sidoqoftë për t'i paraprirë po ju them
19 që mund të jetë nevoja për të bërë një ndryshim të listës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, z. Prokuror.

22 Ekipet e Mbrojtjes janë -- u është kërkuar gjithashtu të
23 na thonë nëse duan të paraqesin prova. Secili prej ekipeve ka
24 thënë që po, do të paraqesin provat e tyre.

25 Gjithashtu i kemi kërkuar ekipeve të Mbrojtjes të na

1 japin informacion lidhur me statusin e dëshmitarëve dhe kohën
2 që do ju nevojitet për t'ju bërë pyetje dëshmitarëve të vet,
3 dhe nëse do të kërkojnë pranim të deklaratave apo
4 transkripteve të mëhershme sa i takon dëshmime me gojë sipas
5 rregullës 153, 155 të Rregullores.

6 I kemi marrë, pra, disa informacione lidhur me këtë nga
7 ekipet e Mbrojtjes, siç e thashë. Do ta trajtoj pak më vonë
8 këtë.

9 Fillimisht marr parasysh një kërkesë të Mbrojtjes Januzi
10 që ka thënë që duhet të lëshojmë fletëthirrje për dëshmitarë.

11 Mbrojtja e z. Januzi, e kam kuptuar drejt unë që ju do të
12 kërkonin që të lëshojmë fletëthirrje për dëshmitarë që t'i
13 thërrasim këtu?

14 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Lidhur me këtë, z. Rees, do të duhet të prezantoni fillimisht
17 një listë përfundimtare të dëshmitarëve, dhe një përmbledhje
18 të dëshmime të tyre. Kjo në fakt vlen për të gjitha ekipet e
19 Mbrojtjes. Dhe pasi të bëjmë ne vlerësimin tonë të listës
20 përfundimtare, do të trajtojmë çështjen e fletëthirrjeve, nëse
21 do jetë ende nevoja.

22 Prandaj një kërkesë e këtij lloji në këtë fazë të
23 procesit është e parakohshme.

24 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mund të them
25 diçka?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Patjetër. Fjala është për ju.

3 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E kuptoj atë që
4 po thoni. Tri dëshmitarët që kam thënë unë, për të cilët do të
5 doja të urdhëronit një fletëthirrje, dy janë punonjës të ZPS-
6 së dhe një është një oficer apo është punonjës i një
7 institucioni të pavarur hetues.

8 Këtë hetuesin e pavarur e lemë mënjanë për momentin. Nuk
9 e di a do na duhet një fletëthirrje për këtë person
10 konkretisht se kjo mund të trajtohet edhe *inter partes*, mes
11 palëve, pra, kur të diskutojmë dhe çështjen e dy telefonave
12 celularë. Edhe unë shpresoj t'i vjelim frytet këtij diskutimi,
13 dhe mbase nuk do jetë nevoja që të kërkojmë fletëthirrje.

14 Tani për këto dy punonjësit e ZPS-së arsyeja pse kam
15 kërkuar unë fletëthirrjen është se ne e kemi kërkuar këtë në
16 komunikim mes palëve, i kemi kërkuar Prokurorisë të na i
17 sjellë punonjësit, t'i bëjnë edhe ata pyetje, edhe t'u bëjmë
18 ne kundërpjetje ose të bëjmë ne pyetje të parët. Dhe
19 Prokuroria kanë thënë që nuk kanë për ta bërë këtë pa një
20 urdhër.

21 Një opsion tjetër është që Prokuroria të na -- të na
22 lejojmë t'i intervistojmë ne këta dy punonjës të Prokurorisë,
23 përgatisim ne një përmbledhje. Por fillimisht duhet që
24 Prokuroria të na i vendosë në dispozicion këta dy punonjës të
25 Prokurorisë, se përndryshe ne nuk kemi se si të bëjmë një

1 përmbledhje të dëshmisë së tyre. Dhe do të duhet që të
2 mbështetemi vetëm në rrethanat aktuale. Ne e dimë që këta
3 persona kanë diçka për të thënë, prandaj dhe është e
4 nevojshme.

5 Prokuroria e di shumë mirë për çfarë duam të flasim ne me
6 këta dy dëshmitarë. Dhe një opsion tjetër do ishte sikur t'i
7 marrë vetë ZPS-ja deklaratat nga këta dy punonjës lidhur me
8 rrethanat që janë paraqitur në dosjen paragjyqësore. T'i
9 lexojmë ne pastaj deklaratat edhe të shohim si mund të
10 vijojmë.

11 Por për momentin ZPS-ja nuk po bashkëpunon lidhur me
12 këtë. Prandaj, ne paraprakisht e dhamë edhe mund -- deshëm
13 t'ju njoftimin për mundësinë që mund të kërkonim fletëthirrje.
14 Edhe do ta shqyrtojmë pastaj dëshminë e tyre kur ta japin
15 dëshminë këta dëshmitarë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Ka diçka për të thënë Prokuroria lidhur me këtë?

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Unë them të ndjekim procedurat që
20 ekzistojnë lidhur me këtë. Nëse parashtrimet e këtyre
21 dëshmitarëve -- nëse do bëjnë parasht -- nëse do bëhet
22 parashtrimin e duhur për këta dy dëshmitarë, atëherë do t'u
23 kundërpërgjigjemi sipas rregullores përkatëse.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 rregull.

1 Fjala është për ju, Avokat.

2 Z. REES: [Përmes videolidhje] [Përkthim] Përgjigja e z.
3 Hafetz nuk na ndihmon aspak. Unë ngrita, unë dhashë dy opsione
4 që t'i marrë parasysh Prokuroria që do na ndihmojnë ne në
5 përgatitjen e gjykimit në mënyrë që të vijojmë në mënyrë të
6 shpejtuar dhe ta mbyllë Prokuroria paraqitjen e provave dhe të
7 kalojmë ne.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit që e caktuat rendin e gjërave se si duhet të
10 veprojmë. E dëgjova shumë mirë çfarë thatë. E dëgjova shumë
11 mirë Prokurorin. Do t'i marrim parasysh opsionet e dhëna. Dhe
12 thashë dhe çfarë mendon Trupi Gjykses që është masa më e
13 duhur.

14 E marrim parasysh propozimin tuaj. Nëse është nevoja do
15 ju kontaktoj unë më tej për këtë.

16 I drejtohem ekipeve të Mbrojtjes të na njoftoni lidhur me
17 listën tuaj të dëshmitarëve. Ne i kemi marrë parashtrimet,
18 disa i keni bërë me gojë sot gjatë seancë.

19 Tani i ftoj ekipet e Mbrojtjes të na thonë nëse mund të
20 dorëzojnë deri të hënën, 4 nëntor, listë të dëshmitarëve
21 bashkë me informacionet përkatëse. Kur them "informacionet
22 përkatëse", e kam fjalën, listë dëshmitarësh, përmbledhjen për
23 secilin dëshmitar, periudhën kohore që do ju nevojitet për t'i
24 marrë në pyetje apo nëse -- nëse do ta bëni -- do të jenë
25 dëshmitarë të rregullës 153 deri 155, modalitetet. Pra, njësoj

1 siç e ka dorëzuar Prokuroria kur dorëzoi parashtimet e veta,
2 si një shtojcë.

3 Pra, ose të hënën më 4 nëntor ose një datë tjetër, por
4 keni parasysh -- duke marrë parasysh që situatën ne duam, ne
5 planifikimin e kemi që Mbrojtja të fillojë me provat e veta
6 më -- në dhjetor 2024. Kjo të jetë parasysh.

7 Fillimisht le ta marri fjalën Mbrojtja e z. Shala.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Për mua 4 nëntor është e
9 realizueshme. Mund të bëhet.

10 Siç tha dhe ZPS-ja do të bëjnë dhe ata një kërkesë brenda
11 shtatë ditësh, sa i takon shtimeve që do të kenë në listën e
12 provave materiale. Ne kemi komunikuar paraprakisht lidhur me
13 dëshmitarët. Tani sigurisht që ne varemi dhe nga Prokuroria se
14 si do të paraqesë provat e veta. Ne e dimë që Prokuroria ka
15 vetëm dy dëshmitarë, po sigurisht që ata thanë që mund të ketë
16 një ndryshim sepse do të dorëzojnë një mocion. Ne do t'u
17 përgjigjemi po duke marrë fillimisht parashtimet e tyre me
18 shkrim.

19 Por unë siç ju thashë nuk ka asnjë arsye pse deri në
20 datën 4 nëntor Mbrojtja e -- Mbrojtja e z. Shala nuk mund të
21 japë listën siç na thatë ju.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Mbrojtja e z. Bahtijari, fjala është për ju nëse keni ndonjë
24 parashtim.

25 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kam

1 asnjë parashtrim. 4 nëntor është krejt okej edhe për mua.

2 Mbrojtja e z. Januzi, fjala është për ju.

3 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Fatkeqësisht ne
4 nuk mundemi për datën 4 nëntor. Unë ju thashë dhe para
5 pushimit, për mua e mundshme është data 18 nëntor. Unë e kam
6 thënë, nuk do hyj shumë në hollësi, se më keni kërkuar që të
7 mos flas shumë me hollësi, por kur kemi negociuar me Zyrën
8 Administrative për hetimet tona në terren, kjo ka pasur një
9 ndikim në afatet kohore dhe ne nuk do të fillojmë dot deri 4
10 nëntor me hetimet tona në terren për shkak që ka -- për shkak
11 të politikave që ka Zyra për Mbrojtjen.

12 Kështu që nuk jemi në gjendje ta dorëzojmë dokumentin
13 përkatës deri në 4 nëntor, por brenda datës 18 nëntor.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
15 marrim parasysh. Dëgjova një "por".

16 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kam dhe diçka
17 për të thënë. Megjithatë unë nuk mendoj që do ketë problem kjo
18 për fillimin e paraqitjes së provave nga ana e Mbrojtjes. Jo
19 vetëm të fillojë po edhe të mbarojë në dhjetor të këtij viti.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Prokuror, fjala është për ju.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Më falni për ndërprerjen.

23 Që të jemi të sigurt që e kam kuptuar drejt. Për
24 parashtrimin që thamë ne për mocionin, nuk thamë shtatë ditë.
25 I drejtohem Mbrojtjes së z. Shala. Thamë brenda 14 ditësh do

1 ta dorëzojmë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
3 Shtatë ditë, shtatë ditëshi ishte për provat që donin të
4 shtonin në listën e provave materiale. Ishte, kishte lidhje me
5 të dhënat e telefonëve.

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit. Do ju bëj dhe një
7 sqarim tjetër.

8 U kujtova gjatë pushimit që ne i kemi të gjitha, me
9 përjashtim të materialit numër 3. Do të ishte shumë efikase
10 mbase që të dorëzojmë kërkesën ne për ndryshimin e listës --
11 listave sipas rregullës 102(1)(b) për këto dy materiale. Për
12 ato që kemi, domethënë. Dhe këtë mund ta dorëzojmë që nesër
13 dhe më pas të dorëzojmë një mocion të dytë për materialin që
14 s'e kemi ende. Kjo do ta përshpejtojë gjykimin.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit. Ne duam sigurisht të përshpejtojë gjykimin, por
17 s'duam të nxitohemi. Po sa herë të ketë mundësi për ta
18 përshpejtuar, ne do ta bëjmë këtë.

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Shikoj që edhe ekipet e miratojmë në heshtje edhe kam
22 përshtypjen që edhe ekipet e tjera do ishte mirë që të japin
23 miratimin e tyre sa më shpejt të jetë e mundur.

24 Shikoj z. Rees që pohon me kokë. Do ishte mirë që të
25 shikoja pohimin, gjithashtu, edhe të Avokates së z. Bahtijari.

1 E pashë dhe këtë. Faleminderit.

2 Kalojmë te pika tjetër. Ekipet e Mbrojtjes janë pyetur në
3 qoftë se ata do bëjnë njoftim për alibi. Kamë marrë për sa i
4 takon parashtrimeve tuaja.

5 Do i kërkoja së pari Mbrojtjes së z. Januzi që nuk do të
6 parashtrojë një mbrojtje alibie.

7 Z. REES: [Përmes videolidhje] [Përkthim] Jo, nuk do të
8 ndjekim këtë pistë, jo.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Tani kalojmë tek pika tjetër që ka të bëjë me rendin e
12 paraqitjes dhe pyetjet e dëshmitarëve.

13 Prokuroria pritej që të jepte parashtrimet e veta sa i
14 takon rendit të cilin synon që të thërrasë dëshmitarët,
15 përfshirë këtu listën e dëshmitarëve si dhe format e marrjes
16 në pyetje të dëshmitarëve si për shembull përmes videolidhje
17 dhe mundësish për dëshmitarin e parë që të fillojë të japë
18 dëshminë e vet në javën e 11 nëntorit të vitit 2024 pas
19 parashtrimeve paraprake të palëve.

20 Kemi marrë shënim synimin e Prokurorisë që të fillojmë
21 dëshmitarin të parë pasi të përfundojmë parashtrimet
22 fillestare për çështjen. Megjithatë, duke marrë parasysh
23 numrin e dëshmitarëve që janë dy dëshmitarë, ky është
24 informacion publik tani, koha që parashikohet nga Prokuroria
25 për këta dëshmitarë do të donim që lidhur me këtë t'i kërkojmë

1 Prokurorisë në qoftë se është e mundur që të dy dëshmitarët,
2 pra domethënë që edhe pyetja nga Prokuroria dhe pyetjet
3 plotësuese nga palët e të akuzuarve të mund të përfundojnë nga
4 11 deri me 15 nëntori, në qoftë se do të vazhdojmë me planin
5 që të fillojmë me deklaratat hapëse për lëndën gjyqësore me
6 datën 8 nëntor. Domethënë, a është e mundur kjo, po i kërkoj
7 Prokurorit të shprehet në qoftë se është e mundur që të dy
8 dëshmitarët të mund përfundojnë brenda këtij afati kohor.

9 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, është
10 kohë e përshtatshme për ne. Mendojmë se mund të përfundojmë
11 brenda kësaj periudhe.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do i
13 kërkoja Zyrës Administrative nga aspekti operativ në qoftë se
14 një gjë e tillë do ishte e mundur për ju për t'u realizuar.

15 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
16 Po, shumë shkurt dua të them që është e mundur për neve që të
17 bëjmë organizimet logjistike të mundshme që dy dëshmitarët të
18 jenë të pranishëm gjatë javës së cituar prej jush.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Trupi Gjygues ju kërkon ekipeve të Mbrojtjes që të
22 shprehen sa i takon disponueshmërisë së tyre për të qenë të
23 pranishëm me datë 8 që është ditë e premte, 8 nëntor 2024.
24 Ditë e premte si dhe javën pasuese në mënyrë të tillë që të
25 mund të përfundohen dëshmitarët e Prokurorisë gjatë javës

1 pasuese. E kam fjalën këtu nga 11 deri 15 nëntor.

2 Kjo do t'i lejonte ZPS-së që të përfundonte sapo dëgjuam
3 parashtrimet dhe dëgjuam gjithashtu mundësi nga ZPS-ja që të
4 thërrasin edhe një dëshmitar të tretë. Po këtu ne po
5 planifikojmë, ne në holandisht themi që të planifikosh do të
6 thotë të ecësh përpara. Pra, do të donim që të arrinim në
7 përfundimin që dëshmia e dëshmitarëve të Prokurorisë të mund
8 të përfundojë në javën nga 11 deri 15 nëntor.

9 Kështu që do ju kërkoja palëve ekipeve të Mbrojtjes që të
10 siguronin edhe të konfirmonim disponueshmërinë e tyre. Jo
11 vetëm për datën 8 nëntor që është ditë e premt,e por
12 gjithashtu për gjithë javën pasuese, domethënë nga e hëna 11
13 nëntor deri në të premten, 15 nëntor 2024. Do ju kërkonim të
14 jepnit konfirmimin tuaj deri nesër në orën 1.00.

15 Parashtrimet që kanë të bëjnë me pyetje lidhur me rendin
16 e paraqitjes si dhe çështje që kanë të bëjnë me marrjen në
17 pyetje të dëshmitarëve nga tri ekipet e Mbrojtjes. Ndërkohë
18 ekipet e Mbrojtjes janë përgjigjur që për momentin nuk keni
19 mundësi që t'i jepni informacione lidhur me këto pika,
20 megjithatë ne dëgjuam se kur do të keni mundësi ju që të na
21 thoni më tepër lidhur me këto aspekte.

22 Gjithsesi në udhëzimet edhe në urdhrat gojorë mund t'i
23 kthehemi përsëri kësaj pike. Ndërkohë që tema ose pika e
24 fundit që është pika e fundit për parashtrimet tona sot.
25 Megjithatë do t'ju jap juve fjalën përpara. Më prisni një

1 çast.

2 Po thoja që kjo është pika e fundit në rendin e ditës në
3 vendimin që ju kemi dërguar sa i takon seancës për përgatitjen
4 e lëndës.

5 Mbrojtja e z. Shala e keni ju fjalën.

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Komenti i vetëm që do bëja sa i
7 takon rendit të paraqitjes së dëshmitarëve të Prokurorisë, ne
8 mund të themi në vija të përgjithshme se sa kohë na duhet neve
9 për pyetjet në emër të Mbrojtjes të z. Shala.

10 Por ndërkohë janë edhe ekipet e tjera të Mbrojtjes.
11 Megjithatë, pra, ndoshta do të ishte më mirë që të kemi një
12 dëshmitar atë javë dhe pastaj dëshmitarin tjetër në dhjetor.
13 Domethënë që ta kemi pjesërisht në nëntor dhe në dhjetor,
14 kështu që për të qenë i qartë besoj që do ishte mirë që ne të
15 mund të përfundojmë me dëshmitarët e Prokurorisë brenda
16 nëntorit dhe dhjetorit dhe pastaj të fillonte Mbrojtja,
17 domethënë që të mos kishim ndërprerje, që të fillonte Mbrojtja
18 me dëshmitarët e vet dhe pastaj të kishim ndërprerjen për
19 fundin e vitit dhe pastaj të vazhdonim më tej.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Gjëja
21 më e saktë për t'u thënë është që ne do përfundojmë
22 dëshmitarin e parë. Domethënë, me të gjitha palët, me të
23 gjitha ekipet e Mbrojtjes do të vazhdojnë domethënë
24 kundërpyetje me dëshmitarin e parë. Të përfundojnë të gjitha
25 palët pyetjet për dëshmitarin e parë pastaj do të vazhdojmë me

1 dëshmitarin e dytë. Kështu do të vijojmë, ky është synimi.

2 Ideja ose planifikimi do të ishte që do ishte mirë që ne
3 të përfundonim brenda asaj jave, por në qoftë se për një arsye
4 ose një tjetër ose në qoftë se ne shohim që nuk përfundojmë
5 dot brenda një javë, sigurisht që do të marrim kohën e
6 nevojshme. Se e thashë edhe më përpara që nuk do të nxitojmë
7 pa qenë e nevojshme.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, faleminderit. E qartë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull.

11 Do të kalojmë tek pika e fundit të rendit të ditës që
12 janë dëshmitë jogojore. Trupi Gjykues ka kërkuar parashtrimet
13 e palëve lidhur me faktin nëse pranueshmëria e provave
14 jogojore do të vendoset në kohën e parashtrimeve të tyre gjatë
15 gjykimit ose në qoftë se do jepet -- do i vihet në dispozicion
16 Trupit Gjykues pasi i janë dhënë palëve mundësia për
17 parashtrimet e tyre. Pra do i jepet Trupit Gjykues përpara se
18 sa ai të marrë vendimin e vet.

19 Ne kemi mbajtur shënim parashtrimet e ZPS-së. Kemi marrë
20 parashtrimet e tyre, ndërkohë që kemi disa pyetje të tjera
21 lidhur me këtë aspekt. Na kemi dhënë një informacion njoftues
22 lidhur me këtë megjithatë sa i takon hollësive që kanë të
23 bëjnë me këtë aspekt do kërkoja që të kalojmë në seancë
24 private. Të shohim në seancë private në qoftë se mund ta
25 shtjellojmë çështjen private -- në seancë private ose në qoftë

1 se mund ta shtjellojmë atë në seancë publike.

2 Do i kërkoja Sekretares për momentin që të na kalojë në

3 seancë private

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 jemi në seancë publike.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Atëherë, do e përsëris edhe një herë për hir të
20 publicitetit që Mbrojtja e z. Shala u pyet që të jepte
21 parashtrime të tjera të hollësishme sa i takon asaj çfarë
22 është parashtruar në dokumentin 482 në paragrafin 19. Dhe
23 Mbrojtja tha që aspekti është i qartë dhe si rezultat nuk
24 është e nevojshme që të bëhen parashtrime të tjera më të
25 hollësishme.

1 Pyetja ime e radhës i drejtohet Mbrojtjes së z.
2 Bahtijari. Marrim parasysht që ju gjithashtu do të kërkon
3 përjashtim të materiale të caktuar dhe ju mendoni që
4 kundërshtime të caktuar do të duhet që të vendosen përpara
5 sesa të fillohet me dëshminë e dëshmitarëve.

6 Avokat, a dëshironi që të bëni parashtrime të tjera
7 lidhur me këtë aspekt?

8 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. Me sa e
9 kuptojmë ne Prokuroria do bëjmë mocione për këto aspekte,
10 kështu që dëshirojmë që së pari t'i përgjigjemi këtyre
11 mocioneve.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
13 do ta trajtojmë këtë siç parashikohet në Rregulloren e Dhomave
14 të Specializuara të Kosovës dhe do vazhdojmë, do ju bëjmë të
15 mundur palëve që të bëjnë parashtrimet e tyre siç parashikohet
16 në Rregulle.

17 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 qoftë se dëshironi që të bëni parashtrime të tjera përveç asaj
21 çfarë përmendet në dosjen paraprake, Mbrojtja e z. Januzi do
22 ju kërkoja që të jepnit shpjegimet përkatëse sa i takon
23 paragrafëve 65(b), (c), (d), lidhur me provueshmërinë dhe
24 kundërshtimet që ju keni për provueshmërinë e këtyre
25 materialeve.

1 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Lidhur me
2 çështjet që ju përmendët që parashikohen në paragrafët 65
3 germa (b), (c) dhe (d), siç e kam kuptuar siç e kam kuptuar
4 Prokuroria kërkon që të bëjë një mocion për të pranuar
5 materiale shkresore. Ndryshe nga kolegët e mia, nga z. Cadman
6 dhe znj. Gerry, unë mendoj që do ishte më mirë që të shohim
7 njëherë se cilat janë këto mocione, çfarë do përmbajnë, cila
8 është përmbajtja e këtyre mocioneve dhe pastaj të shprehemi.
9 Pra, kjo është rruga që parashikohet në Rregulloren.

10 Kështu që sa i takon këtij aspekti ne do presim që të
11 bëjë, të dorëzojë mocionin Prokurori.

12 Ne pajtohemi me Prokurorin që pranueshmëria për këtë
13 aspekt duhet që të përcaktohet përpara sesa të japë dëshminë
14 dëshmitari përkatës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, Avokat.

17 Kemi mbërritur në fundin e aspekteve të cilat janë
18 përcaktuar si pjesë e rendit të ditës për konferencën për
19 përgatitjen e gjykimit.

20 Përveç pikave që kemi diskutuar tani do të doja që të
21 shtoj edhe disa pika të tjera. Parashtrimi i vonuar i
22 parashtrimeve të protokolluara dhe dokumenteve të tjera
23 përkatëse.

24 Së pari, Trupi Gjygues vëren se Mbrojtja e z. Januzi
25 dorëzon parashtrimet për seancën e sotme, parashtrimet 495 një

1 ditë pas afatit të përcaktuar nga Trupi Gjykses pa kërkuar nga
2 Trupi Gjykses që të shtyjë afatin.

3 Gjithashtu edhe Mbrojtja e z. Bahtijari ka dorëzuar po
4 kërkesë -- pa kërkuar leje parashtrime të mëtejshme për
5 seancën e ditës së sotme të premtën, që është disa ditë është
6 tre ditë pas afatit të përcaktuar nga Trupi Gjykses.
7 Gjithashtu vërejmë që Mbrojtja e z. Bahtijari nuk ka bërë
8 parashtrim sa i takon informacionit për praninë e dëshmitarit
9 ose të Mbrojtësit ose bashkëmbrojtësit gjatë seancës të
10 parashikuar deri me 20 dhjetor 2024, sikurse është urdhëruar
11 në parashtrimin 479, paragrafi 32(b) edhe e dërguar përmes
12 postës elektronike.

13 Ju bëjmë thirrje ekipeve të Mbrojtjes që të respektojnë
14 afatet që përcaktohen në urdhrat dhe udhëzimet e Trupit
15 Gjykses dhe në veçanti ne i referohemi rregullës 9 të
16 Rregullores për të shqyrtuar ose për të rrëzuar parashtrime të
17 tjera në të ardhmen të cilat do dorëzohen përtej afateve të
18 përcaktuara nga Trupi Gjykses.

19 Palët njoftohen se në qoftë se nuk respektojnë afatet e
20 përcaktuar nga Trupi Gjykses ka të ngjarë që të parashtrimet e
21 tyre të mos konsiderohen fare nga Trupi Gjykses.

22 Pika tjetër ka të bëjë me rikalsifikimin me urdhrat për
23 riklasifikimit. Dhe për këtë pjesë të urdhrat do të doja t'i
24 kërkoja Sekretares të na kalojë në seancë private.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

24 jemi në seancë publike.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pashë

1 një dorë të gritur. Mbrojtja e z. Bahtijari, pashë dorën e
2 ngritur përpara një çasti. Nuk e di në qoftë se donit që të
3 merrnit fjalën apo jo, apo ndërruat mendjen?

4 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po mendoja
5 që të jepja një shpjegim, megjithatë nuk mendoj se është e
6 nevojshme. E dëgjova urdhrin tuaj. Ju e dini gjendjen time
7 përpara një jave, kështu që nuk është e nevojshme besoj që të
8 bëj parashtime të tjera, kështu që për këtë arsye e ula
9 dorën.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull, faleminderit.

12 Tani dëshiroj t'ju kërkoj palëve të na thoni në qoftë se
13 kanë aspekte të tjera që dëshirojnë që të ngrejne. Ju lutem na
14 e thoni në qoftë se aspektet duhet që të trajtohen në seancë
15 publike apo private.

16 Do të filloj së pari me Prokurorin, me Zyrën e Prokurorit
17 të Specializuar.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi asgjë
19 tjetër përveç se t'i bëjmë me dije Gjykatës që sipas kërkesë
20 së Bahtijarit për këtë konferencë edhe sa i takon vizitës në
21 terren, ne folëm *inter partes* me avokatin dhe jam optimist që
22 do gjejmë një zgjidhje midis palëve, kështu që nuk do jetë e
23 nevojshme që të bëhet një kërkesë formale lidhur me këtë.
24 përveç kësaj nuk kemi asgjë tjetër për të shtuar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 E përgëzojmë qasjen *inter partes* sa i takon kërkesave të
3 ndryshme të cilat janë ende pezull pa i sjellë, domethënë e
4 inkurajojmë gjithmonë zgjidhjen ndërmjet palëve, pa qenë e
5 nevojshme që ato që mund të zgjidhen ndërmjet jush të ngrihen
6 përpara Trupit Gjykues.

7 Zyra Administrative a ka ndonjë gjë për të thënë:

8 Z. NILSSON: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të thënë nga
9 Zyra Administrative.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Tani kalojmë tek Mbrojtja e z. Shala. E keni fjalën ju
13 tani në qoftë se doni të bëni parashtime të tjera.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju falënderoj të nderuar Gjykatës.
15 Vetëm një pikë nuk është cekur që ka të bëjë me përgatitjen e
16 dëshmitarëve. Sigurisht që ne kemi bërë parashtime me shkrim
17 për këtë pikë dhe ne e kundërshtojmë çdo formë të përgatitjes
18 së dëshmitarëve dhe i referohemi vendimit të mëparshëm të
19 Trupit Gjykues në çështjen gjyqësore të Salih Mustafës, sa i
20 takon rrugës që duhet të ndiqet për këtë pikë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 faleminderit, avokat, për parashtimet.

23 Unë e thashë më herët sot se Trupi Gjykues merr parasysh
24 se Mbrojtja e Shalës nuk ka kundërshtim lidhur me udhëzimet
25 për familjarizimin e dëshmitarëve që është miratuar nga Trupi

1 Gjykues në Çështjen 04. Para përshtypjen që e kam trajtuar sa
2 ç' duhet këtë element, dhe prandaj e lashë këtu. Megjithatë në
3 qoftë se doni të shtoni diçka tjetër mund të vazhdoni.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ka dallim
5 midis familjarizimit të dëshmitarëve, Njësisë së Mbrojtjes së
6 Dëshmitarëve dhe përgatitjes së dëshmitarëve që është
7 propozuar. Ndoshta unë nuk e kam kuptuar situatën siç duhet
8 por unë i kuptoj këto si proces të ndryshme.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull. Por unë e kam kuptuar që ju nuk jeni në kundërshtim
11 me linjën e udhëzuar nga Trupi Gjykues dhe këtë shprehjen ja u
12 lexova thjesht për t'u siguruar që ky është qëndrimi juaj. Unë
13 mendoj që e kemi trajtuar këtë shqetësimin tuaj dhe mendoj që
14 e kemi marrë shënim dhe i kemi zgjidhje si me thënë këtij
15 shqetësimin tuaj.

16 Do vazhdojmë me Mbrojtjen e z. Bahtijari. A mendoni që ka
17 ndonjë aspekt që do të duhet të diskutohet tani:

18 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Së pari,
19 lidhur me vizitat në terren. Jemi në komunikime të
20 vazhdueshme. Nuk e kemi ezauruar akoma vizitën megjithatë jemi
21 më pranë vizitës dhe ju falënderojmë shumë për ndihmën e dhënë
22 sa i takon kësaj.

23 Do të kemi mundësi të bëjmë parashtime të tjera lidhur
24 me përgatitjen e dëshmitarëve përveç familjarizimit të
25 dëshmitarëve, dhe këto parashtime do t'ja u japim me shkrim

1 sipas rastit aktorëve përkatëse. Ne parapëlqejmë këtë lloj
2 qasjeje. Domethënë, do parapëlqenim që të jepnim parashtrime
3 me shkrim.

4 Sa i takon parashtrime që kemi dhënë përpara kësaj seancë
5 ato kanë qenë vërtetë të shkurtra dhe nuk mendojmë që kemi
6 qenë shterues në ato që kemi cekur në to. Pra, ne do
7 parapëlqenim që afati të --

8 Sa i takon parashtrimeve për lidhjen e përgatitjes, jo --
9 ka të bëjë jo vetëm me faktin që dokumentet e Prokurorisë do
10 të jenë të pranueshme apo jo, sepse Prokuroria po -- ka shumë
11 të ngjarë që të mbështetet në dokumente të cilat do t'i
12 paraqesë përpara dëshmitarëve për provueshmërinë e tyre.
13 Kështu që qëndrimi ynë është që Prokuroria kur të shprehet për
14 provueshmërinë dhe kur të shprehet për mocionet e veta duhet
15 që të përfshijnë edhe përgatitjet, sepse ne mendojmë që këto
16 dokumentet nuk duhet t'i vihen përpara dëshmitarit përpara
17 sesa dëshmitari të japë dëshminë. Pra, me fjalë të tjera, ne
18 mendojmë që përgatitja e dëshmitarit si çështje do të duhet që
19 të përfshihet në mocionet dhe përgjigjet që kanë të bëjnë me
20 përjashtimin e këtyre dokumenteve të përgatitura nga anëtarë
21 të Prokurorisë së Specializuar dhe kolegë ose zyrtarë të tjerë
22 të lidhur.

23 Ndërkohë, elementi i dytë ose aspekti i dytë ka të bëjë
24 me aspektin mjekësor. Gjithësi do të them shkurtimisht lidhur
25 me aspektin mjekësor që ne kemi një vendim rreptësisht

1 konfidencial dhe pasojë e saj është që ne do të mundohemi që
2 të sigurojmë ca të dhëna mjekësore vetë, në qoftë se kjo gjë
3 është e mundur. Nuk e di në qoftë se mund t'ju jap njoftim,
4 ose sa për t'ju dhënë një ide dua që t'ju them që kjo do të
5 marrë pak më shumë kohë sesa data 2 nëntor.

6 Do të bëjmë më të mirën tonë të mundshme që të
7 përgjigjemi deri me datë 2 nëntor megjithatë, më duket pak e
8 vështirë për t'u përgjigjur deri me 2 nëntor. Gjithsesi,
9 Trupin Gjykues do ta informojmë në vazhdimësi. Nuk dua të
10 futem shumë në hollësi se jemi në seancë publike, megjithatë
11 do të mundohemi t'i marrim këto informacione vetë, sa më
12 shpejt të jetë e mundur.

13 Atëherë ca prej informacioneve i kemi identifikuar,
14 gjithsesi është çështje disponueshmërie dhe kostoje.

15 Këto ishin aspektet që dëshironim të ngrinim.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit, Mbrojtësja e z. Bahtijari. Atëherë, morën shënim
18 atë çfarë ju thatë lidhur me vizitën në terren.

19 Lidhur me përgatitjen e dëshmitarit, ajo si e kuptoj unë
20 është që në vendimin për sa i takon përgatitjes së gjykimit ne
21 kemi përmendur familjarizimin e dëshmitarëve. Dhe tani e
22 kuptoj më mirë që pse ekipet e Mbrojtjes dëshironin që të
23 bënin konstatime dhe analizime të tjera që kanë të bëjnë me
24 përgatitjen. Do ta shohim, do ta konsiderojmë në më tepër
25 hollësi këtë aspekt, dhe në qoftë se e shikojmë të arsyeshme

1 do t'ju japim kohë shtesë, në mënyrë të tillë që të keni
2 mundësi të shprehni pikëpamjet tuaja lidhur dhe me këtë.

3 Dhe kjo vlen dhe për Mbrojtjen e z. Shala.

4 Atëherë, radhën e ka Mbrojtësi i z. Januzi. Urdhëroni.

5 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit.

6 Kam qëndrimin e njëjtë për sa i përket të procesit të
7 njoftimit të dëshmitarëve me procedurën në Gjykatë me ekipe të
8 tjera të Mbrojtjes.

9 Dua të pyes për planin që keni për pjesën e mbetur të
10 kësaj javës dhe gjithashtu t'ju pyes në lidhje me propozimin
11 që të bëjmë seancë me 8 nëntor dhe javën prej 11 deri 15
12 nëntor. E kam të qartë se Trupi Gjykues ka ndërmend që ta
13 mbajë gjithë atë javë. Ne sa i përket disponueshmërisë do t'ju
14 njoftojmë deri nesër. A doni këtë ta bëjmë përmes një
15 parashtrimi me shkrim, apo me email deri nesër në ora 12.00?

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kam
17 të qartë. Nesër deri në orën 12.00 duhet të marrim konfirmim
18 prej jush në lidhje me disponueshmërinë dhe kjo nuk është
19 ftesë.

20 Dhe e dyta, është me rëndësi që të bëhet një parashtrim
21 për të pasur të gjitha gjërat në procesverbal dhe në
22 dokumentacionin e çështjes. Ka disa emaile që nuk janë të
23 përfshira në dokumentacionin e çështjes. Sa më pak që të
24 shkëmbehem me emaile, aq më shumë i shërbejmë interesit
25 publik.

1 E kam -- dhe kjo është arsyeja e vetme -- e kam të qartë
2 z. Rees, se është ma e ndërlikume të bëhet parashtrim në
3 krahasim me një email, mirëpo në këtë mënyrë i shmangemi çdo
4 mospërfshirje dokumentacionit.

5 Z. REES: [Përkthim] Atëherë, kam një pyetje. A do të
6 vazhdojmë dhe nesër dhe pasnesër me seanca?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
8 shkoni shumë përpara, Mbrojtës. Sigurisht që Trupi Gjygues do
9 t'ju tregojë se cili është programi dhe kalendari i seancave
10 dhe duhet të keni besim në ne.

11 Tani, të gjitha palët dhe përfaqësuesi i Zyrës
12 Administrative kanë bërë me dije se nuk ka mbet asnjë gjë
13 tjetër që dëshirojnë të diskutojnë me Trupin Gjygues në këtë
14 moment. Kjo do të thotë se për sot e përfundojmë punën dhe do
15 takohemi nesër përsëri në orën 11.30, për seancë.

16 Do të përgatisim urdhrat që duhen përgatitur me udhëzime
17 të nevojshme dhe pas këtyre urdhrave gojorë do t'ju bëjmë me
18 dije se cilat do të jenë vendimet, pra çfarë vendimesh ka
19 ndërmend të nxjerrë Trupi Gjygues në javët që vijojnë, në
20 mënyrë që ju ta keni të qartë.

21 Dhe thashë 11.30, por mendoj që më mirë ta shtyjmë në
22 2.00. do takohemi në orën 2.00 nesër për seancë. Atëherë, në
23 ora 2.00 do të japim urdhrat gojorë, do ta bëjmë të qartë se
24 çfarë udhëzimesh do t'ju japim palëve dhe me -- në atë moment
25 pastaj do të përmbyllim Konferencën Përgatitore. Kemi qenë

1 mjaft efikase në përdorimin e kohës sot në mëngjes. Ju
2 faleminderit për bashkëpunimin.

3 I falënderoj palët, i falënderoj Zyrën Administrative,
4 përkthyesit, stenografin, ekipin audio-vizual, ekipin e
5 sigurisë.

6 Dhe edhe një herë theksoj që e çmoj shumë frymën e
7 bashkëpunimit midis palëve në përpjekjet e tyre për t'i bërë
8 këto procedura sa më të lehta dhe sa më të shpejta.

9 Këtu mbyllet seanca.

10 --- Konferenca Përgatitore për Gjykim mbyllet
11 në orën 12.35

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25